



Tingujt e zogjve në mëngjes

Lyden av fugler om morgenen


 LIDA Portugal

 Vilius Aistis Vilimas

 Maria Hila

 5


 Shqip sq / norsk nb



Yulia, bashkëshorti i saj dhe vajza e tyre e vogël jetonin në një fshat të vogël dhe të qetë në Ukrainë. Yulia e adhuronte të zgjohej çdo mëngjes nga tingujt e zogjve. Ajo nuk e kishte menduar kurrë se do të jetonte larg shtëpisë, ose që nuk do të zgjohej nga tingujt e zogjve në mëngjes.

• • •


Yulia, mannen hennes og den lille datteren deres bodde i et lite, rolig tettsted i Ukraina. Yulia likte veldig godt å våkne hver morgen til lyden av fugler. Hun trodde aldri at hun skulle bo langt hjemmefra, eller at hun ikke skulle bli vekket av lyden av fugler om morgenen.



Bashkëshorti i saj ankohej gjithmonë se nuk kishin mjaftueshëm para dhe nisi të pinte shumë. Ata vendosën të provonin fatin e tyre në Portugali. Ndoshta aty mund të fitonin më shumë para për të ndërtuar një shtëpi dhe për të pasur një të ardhme më të mirë për familjen e tyre.

...


Mannen hennes klaget alltid over mangelen på penger, og han begynte å drikke mye. De bestemte seg for å prøve lykken i Portugal. Kanskje de der kunne tjene mer penger til å bygge et hus og en bedre framtid for familien.



Yulia u përshtat mirë me shtëpinë e re, dhe filloi të punonte si pastruese. Klientët e saj e vlerësonin shumë punën e saj të fortë dhe se sa e sjellshme ishte. Bashkëshorti i saj, nga ana tjetër, ndihej gjithmonë e më shumë i papërfshirë. Për shkak të problemit të tij me pijen, punëdhënësit nuk e besonin dhe nuk i jepnin punë.

...


Yulia tilpaset seg det nye hjemmet godt, og hun begynte å jobbe som hjemmehjelp. Kundene hennes satte virkelig pris på arbeidet hennes og den høflige innstillingen hennes. Mannen hennes, derimot, følte seg stadig mer oversett. På grunn av alkoholproblemet hans stolte ikke arbeidsgivere nok på ham til å gi ham arbeid.



Një ditë ai nisi t'i bërtiste Yulias. Më pas, nisi ta shtynte. Të bërtiturat dhe të rrahurat u përkeqësuan, veçanërisht kur ishte i dehur. Yulia ishte e frikësuar për veten dhe për vajzën e saj, por ajo nuk dinte se çfarë mund të bënte.

...

En dag begynte han å kjefte på Yulia. Senere begynte han å dytte henne. Volden økte med skriking og slag, særlig når han var full. Yulia var redd for seg selv og for datteren sin, men hun visste ikke hva hun skulle gjøre.



Kur Yulias më në fund iu desh të shkonte në urgjencën e spitalit me një krah të thyer, ata i thanë se dhuna në familje ishte një problem shumë i madh në Portugali. Ata gjithashtu i thanë se ishte krim dhe se ajo duhej ta raportonte në polici.

...

Da Yulia omsider måtte dra til legevakten på sykehuset med brukket arm, fortalte de henne at partnervold var et stort problem i Portugal. De sa også at det var ulovlig, og at hun burde anmelde det til politiet.



Yulia ishte e rraskapitur dhe nuk donte që vajza e saj e vogël të rritej në një shtëpi ku shikonte çdo ditë dhunë. Yulia kuptoi se shenjat e abuzimit kishin qene aty gjatë gjithë kohës, edhe pse merrnin forma të ndryshme.

...

Yulia var utslitt og ville ikke at den lille datteren hennes skulle vokse opp i et hjem hvor hun var vitne til vold daglig. Yulia innså at tegnene på mishandling hadde vært der hele tiden, selv om de så veldig forskjellige ut.



Yulia shkoi në një qendër për gratë, ku u ndje më e sigurt seç ishte ndjerë në një kohë të gjatë. Nuk ishte ndjerë ashtu qëkur zgjohej nga tingujt e zogjve në mëngjes.

• • •

Yulia dro til et krisesenter, hvor hun følte seg tryggere enn hun hadde gjort på lenge. Hun hadde ikke følt seg sånn siden hun ble vekket av lyden av fugler om morgenen.



LIDA Stories

lidastories.net

Tingujt e zogjve në mëngjes

Lyden av fugler om morgenen

 LIDA Portugal

 Vilius Aistis Vilimas

 Maria Hila (sq), Espen Stranger-Johannessen (nb)

